



Prishtinë: 14.10.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1190_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1969_07_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **29.08.2019**.

në seancën e mbajtur më datë 14.10.2019, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin S.Z., nga Prishtina, me shifër të konsumatorit DFE 46793 si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1969_07_19** i datës 29.07.2019.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 29.08.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: protokollin e shqyrtimit të njehsorit elektrik nr.org02 nr.5441 i datës 12.04.2016 për njehsorin elektrik nr.38952945 konstaton se njehsori elektrik është brenda kufijve të lejuar të matjes. Në ankesë theksohet se DMK në ZRRE vendimin nuk e bazon në protokollin e shqyrtimit të njehsorit por vetëm në analizën e bërë në rrjedhën e energjisë elektrike, pra në krahasimin e shpenzimit të energjisë elektrike para dhe pas periudhës kontestuese. Në ankesë theksohet shpenzimi dhe faturimi si dhe korrigjimi plotësues janë reale dhe kjo duke u bazuar në shpenzimet e energjisë elektrike të muajve të dimrit kur shpenzimi është më i lartë dhe se konsumatori ka mundur të ketë provuar ngrohjen me energji elektrike dhe pastaj nuk e ka vazhduar më për shkak se ngrohja me energji elektrike është e kushtueshme. KESCO



në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_1969_07_19 i datës 29.07.2019 për konsumatorin S.Z. me shifër DFE – 46793 dhe të mbetet në fuqi korrigjimi plotësues.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 28.08.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se në protokollin e shqyrtimit të njehsorit elektrik nr.org.02 nr.5441 të datës 12.04.2016 për njehsorin elektrik nr.38952945 konstatohet se njehsori elektrik është brenda kufijve të lejuar të matjes, Bordi i ZRRE-së thekson se edhe organi i shkallës së parë ka theksuar të njëjtën gjë, pra organi i shkallës së parë në ZRRE në vendimin e saj ka theksuar se bazuar në të gjeturat përkatësisht shqyrtimin e saktësisë së matjes nga qendra e kalibrimit për njehsorin elektrik nr.38952945 konstatohet se gabimi në matje është brenda kufijve të lejuar matës, pra në këtë pikë nuk ka asgjë që duhet të kundërshtohet nga ana e KESCO-s. Gjithashtu Bordi i ZRRE thekson se gjatë analizës së bërë procesverbalit mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 0629582 të datës 19.01.2016 është vërejtur se përveç konstatimit të të dhënave të gjendjes së shpenzimit të njehsorit elektrik nr. 38952945 të larguar TL=20329 kWh dhe TU=9059 kWh, dhe të dhënave të njehsorit të ri të vendosur nr.30516191 prej TL=000000 kWh dhe TU= 000000 kWh, punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë konstatuar se njehsori nr.38952945 duhet të dërgohet në qendrën e kalibrimit për shqyrtim, si dhe i njëjti shpenzon shumë. Pra Bordi i ZRRE-së thekson se vet punëtorët e KEDS gjatë ndërrimit të njehsorit elektrik kanë konstatuar se njehsori elektrik shpenzon shumë si dhe si i tillë duhet të dërgohet në qendrën e kalibrimit për shqyrtim, dhe duke pasur parasysh se në qendrën e kalibrimit është konstatuar se njehsori elektrik është brenda kufijve të lejuar atëherë Bordi i ZRRE-së thekson se është dashur nga ana e KESCO-s të bëhen analiza të tjera dhe jo të merret meritore vetëm protokollin e shqyrtimit të njehsorit elektrik.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se DMK në ZRRE vendimin nuk e bazon në protokollin e shqyrtimit të njehsorit por vetëm në analizën e bërë në rrjedhën e energjisë elektrike, pra në krahasimin e shpenzimit të energjisë elektrike para dhe pas periudhës kontestuese, Bordi i ZRRE-së thekson se krahasimi i shpenzimeve të energjisë elektrike para dhe pas periudhës kontestuese është një indikator mjaft i rëndësishëm në shqyrtimin e njehsorit elektrik, pasi që tregon qartë profilin e shpenzimit të energjisë elektrike të konsumatorit. Bordi i ZRRE-së thekson se krahasimi i shpenzimeve të energjisë elektrike është i rëndësishëm gjithashtu kur kemi edhe mos përputhje mes procesverbaleve të vet KEDS-it, andaj edhe është e domosdoshme të bëhen krahasime të shpenzimit dhe jo të merret vetëm një procesverbal si meritore gjatë shqyrtimit të lëndës së konsumatorit.

Bordi i ZRRE thekson se konsumatori në fjalë ka pasur edhe një ankesë tjetër në ZRRE për kundërshtimin e faturës dhjetor 2015 të cilën organi i shkallës së parë në ZRRE (Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE) pas shqyrtimit të lëndës së konsumatorit ka nxjerr vendimin ZRRE/DMK_V_1785_03_18 të datës 21.03.2018 me ç'rast ka liruar konsumatorin nga fatura 12150DFE-46793 e datës 29.12.2014 për shkak të konstatimit që njehsori elektrik nr.30516191 nuk ka bërë matje të saktë të shpenzimeve për atë periudhë. Bordi i ZRRE-së thekson gjithashtu se me datë 13.06.2018 KESCO ka kundërshtuar vendimin e DMK-së në Bordin e ZRRE-së, dhe se i njëjti ka nxjerrë vendimin V_992_2018 me të cilin ka konfirmuar vendimin e organit të shkallës së parë të ZRRE, si dhe ka refuzuar pretendimet e KESCO-së, për shkak të mos ofrimit të argumenteve me të cilat do të konfirmohej matja e saktë e njehsorit.



Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se shpenzimi dhe faturimi, si dhe korrigjimi plotësues janë real dhe kjo duke u bazuar në shpenzimet e energjisë elektrike të muajve të dimrit kur shpenzimi është më i lartë dhe se konsumatori ka mundur të ketë provuar ngrohjen me energji elektrike dhe pastaj nuk e ka vazhduar më për shkak se ngrohja me energji elektrike është e kushtueshme, Bordi i ZRRE-së thekson se ky konstatim i KESCO-s nuk qëndron. Bordi i ZRRE-së gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës konstaton se gjendja e fundit e shpenzimeve të evidentuara në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik nr.0629582 të datës 19.01.2016 nuk përputhet me gjendjen e evidentuar në programin e faturimit "CCP" (ang. Customer Care Package) pasi që ekziston një dallim i madh në mes leximit të fundit të njehsorit elektrik të datës 24.12.2015 (faturimi i muajit dhjetor 2015) dhe kohës së ndërrimit të njehsorit 19.01.2016. Pra, Bordi i ZRRE-së thekson se ky dallim i shpenzimit të energjisë elektrike (kilovatorë – kWh) është TL=3805 kWh dhe TU=1622 kWh, dhe nga analiza e bërë shkresave të lëndës vërtetohet se konsumatorit nuk i është bërë kjo prerje e shpenzimit të energjisë elektrike në CCP, pra nuk figuron gjendja e fundit e shpenzimeve pas ndërrimit të njehsorit elektrik nr.38952945, e që do të duhej të bëhej. Bordi i ZRRE-së thekson se KESCO përmes urdhër lejimit/korrigjimit nr.45764DFE-46793 e ka ngarkuar konsumatorin në vlerë financiare **533.73€** duke bërë korrigjimin plotësues për periudhën 24.12.2015 deri me datë 19.01.2016 kur edhe është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik nr. 38952945, e që kjo është në kundërshtim me konstatimet e mëhershme të bëra në vendimet e ZRRE-së, pasi që edhe shpenzimi i mëhershëm (periudha 12/2015) konsumatorit i është anuluar konsumatorit nga ZRRE si shpenzim mujor jo real, e kjo pasi që ka pasur argumente të mjaftueshme që njehsori elektrik nr.38952945 nuk ka bërë matje të saktë. Bazuar në vendimet e nxjerra me herët nga ZRRE (vendimi i DMK në ZRRE dhe vendimi i Bordit të ZRRE), si dhe mos ofrimit të argumenteve të KESCO për korrigjimin plotësues, Bordi i ZRRE-së konstaton se KESCO me rastin e ngarkesës së shtesë nr.45764DPR-46793-46793 të datës 21.06.2018 ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji dhe si të tillë konstaton se vendimi i organit të shkallës së parë ku është kërkuar që të anulohet korrigjimi plotësues nr.45764DFE-46793 i datës 21.06.2018 në vlerë 533.73€, është i saktë.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.08.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit S.Z. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.